

Kart' e-pergjithëshme e apostollit Judhë.

- 1 Judha, shërbëtuar i Jisu Krishtit, edhe i vëllaj i Jakovit, mbë të-thërrituritë që janë të-shënjtëruarë prej Perëndisë, Atit, edhe të-ruajturë prej Jisu Krishtit; Përdëllim, e paq-tim, e dashuri, shumoftë mbë ju.
- 3 Të-dashurë, passi vë çdo kujdes t' u shkruanj juve për shpëtimin' e-bashkëtë, pata nevojë t' u shkruanj juve, e t' u lutem të luf-toni për besënë që u udha një herë shënjto-4 rëvet. Sepse hynë fshehurazi disa njerës, të-cilëtë përpara që moti ishinë shkruarë për ndë këtë dënim, njerës të-pabesë, që kthe-

- njënë hirin' e Perëndisë t'ënë ndë ndyrësi, edhe mohonjëne të-vetëminë Zotëri (Perëndinë), edhe Zotinë t'ënë Jisu Krisht.
- 5 Edhe dua t' u bje juve ndër mëntt, ndonëse ju e dini këtë, se Zoti, si shpëtoj llauzinë nga dheu i Egjiptësë, pastaj i 6 humbi ata që nukë besuanë. Edhe ata ën-gjëjtë që nukë ruajtne gjëndjen' e tyre të-parë, po lanë vëndin' e tyre, i ka ruajturë me të-lidhura të-përjetëshme ndënë errësirë, 7 për gjyqin' e ditës' së-madhe; Posi Sodomat' e Gomorratë, edhe ata qytetetë rreth atyreve, që udhanë ndë kurvëri pas mëny-rës' s' atyreve, edhe vanë prapa tjtëri mishi, janë vënë përpara për shëmbëllesë dyke 8 umunduarë me zjarr të-përjetëshm. Gjithashtu edhe këta, dyke parë ëndërra, ndyrinë mishinë, e pushtetinë e bënë për asgjë, edhe 9 ofiqetë i shanjënë. Po Mihaili, i-par' i ën-gjëjvet, kur dyke luftuarë hahej me djallinë për trupin' e Moisiut, nukë kuxoj të bjerë kundr' ati ndonjë dënim vllasfime, po tha, 10 Zoti të qërtoftë ty. Edhe këta për gjërëra që nuk' i dinë flasënë keq; edhe prishënë mb' ato që i dinë prej naturë, posi shtëzëtë pa 11 mënt. Mjerë ata! sepse ecnë ndë udhët të Kainit, edhe për pagë uderthnë me vrap pas kobimit të Ballaamit, edhe uhumpnë ndë kundrëfjalët të Koreut.
- 12 Këta janë këllirëra ndë gostirat të da-

- shurisë s' uaj, kur han' e pinë bashkë *me ju* pa frikë, e kullosënë vetëhen' e tyre; *janë* re pa ujë që bihenë andej e këtej prej erë-ravet; *janë* drurë vjeshte të pa-pemshim, dy
- 13 here vdekurë, çkulurë nga rrënjëtë; Valë deti t' egra që shkumëzonjënë turpjet' e tyrë; yj që bihen' andej e këtej, për të-cilëtë është ruajtur' errësir' e-zezë për gjithë jetënë.
- 14 Edhe për këta profitepsi edhe Enohu ishtatti prej Adhamit, dyke thënë, "Ja tek erdhi Zoti me mijëra prej shënjtorëvet të ti,
- 15 Që të bënë gjyq përmbi gjithë, edhe të qërtonjë gjithë të-pabesëtë *ndër mest* t' atyreve, për gjithë punërat' e pabesëris' s' atyre që punuanë me pabesëri, edhe për gjithë fjalët e-ashpëra që fajtorë të-pabesë folnë kundr'
- 16 ati., Këta jan' asish që murmurisnjën' e qahenë, dyke ecurë pas dëshërimevet të tyre; edhe goja e atyre flet *fjalë* fort të-trasha, edhe përkëdhelnjënë njerës, që të kenë dobi nga ata.
- 17 Po ju, o të-dashnrë, sillni ndër mëntt fjalëtë që ufolnë më përpara nga apostojt' e
- 18 Zotit t' ënë Jisu Krisht, Se u thoshinë juve, „se ndë kohët të-pastajmë dotë ketë përqeshës që *do'* ecënjënë pas dëshërimevet të pabesërivet të tyrë.,
- 19 Këta jan' ata që ndanjënë veç vetëhen' e tyre, posi shtëzë, që s' kanë Frymë.
- 20 Po ju, o të-dashurë, dyke ndërtuarë ve-

- tëhenë t' uaj përmbi besët t' uaj fort të-shënjtëruarë, e dyke falurë me Frymë të-Shënj-
- 21 tëruarë, Rua.i vetëhenë t' uaj ndë dashurit të Perëndisë, dyke priturë përdëllimin' e Zotit t' ënë Jisu Krisht për jetë të-përjetësh-
- 22 më. Edhe ca i përdëlleni, kur hahenë *me ju*; Edhe
- 23 të-tjerë i shpëtoni me frikë, dyke rrëmbyerë *ata* nga zjarri, *edhe* dyke pasurë mëri edhe atë rrobënë që është fëlliqurë nga mishi.
- 24 Edhe mb' atë që munt t' u ruanjë juve të-pafajm, e t' u qëndronjë juve faqe-bardhë
- 25 ndë gëzim përpara lavdis' së ti, Mbë të-ve-tëminë (të-diturë) Perëndi, Shpëtimtarinë t' ënë, qoftë lavdi edhe madhëri, fuqi edhe pushtet, edhe tani edhe ndë gjithë jetët të-përjetëshme. Amin.